

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

“VISION CONSULTING” SH.P.K

Republika e Shqipërisë

Sot më datë 21.06.2021 në orën 10:30

Neni 1

Emërtimi – Veprimtaria - Ortakët themelues

Është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Vision Consulting” sh.p.k
Themeluesit e shoqërisë janë:

- a) Giancarlo Renzullo, shtetas italian, lindur më 28.06.1971, në Bolzano, banues në Bolzano me numër identifikimi C.F: RNZGCR71H28A952D.
Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetare në 62.730 (gjashtëdhjetëedymijëeshtatëqindetridhjetë mijë) Lekë.
- b) Erion Nexha, shtetas shqiptar, lindur më 14.04.1983 në Lushnje, banues në Durrës me numër identifikimi I30414025J.
Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 44% (dyzetë e katër përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetare në 54.120 (pesëdhjetëekatërmijëenjëqindenjëzetë) Lekë.
- c) Lediana Shabani, shtetase shqiptare, lindur më 18.04.1986 në Durres, banuese në Durrës, më numër identifikimi I65418098A.
Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 5% (pesë përlind) të kuotës së kapitalit themeltare shprehur ne vlerë monetarë në 6.150 (gjashtëmijëenjëqindepesëdhjetë) Lekë.

Neni 2

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e:

- a) Konsulentësh fiskale;
- b) Përpunim të dhënash kontabël për llogari të palëve të treta;
- c) Shërbime Outsorcing për shoqëri të huaja;
- d) Konsulencë financiare për të gjitha llojet e bizneseve;
- e) Studimi i tregut për investitorë vendas dhe të huaj;
- f) Hartim dhe projektim i planeve të biznesit, buxhetit dhe analizës financiare të shoqërive tregtare;
- g) Aktivitete të tjera të lejuara nga ligji tregtarë i Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë tregtare private "Vision Consulting" sh.p.k ndodhet në adresën: Rruga "Jordan Misja", Hyrja 1, Apartamenti 5, Zona kadastrale Nr.8330, Nr. i Pasurisë 8/176+1-5, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat, përveçse në rastet kur parashikohet shpërbërja e hershme me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5

Administrimi dhe përfaqësimi.

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj të parashikuara nga ligji dhe statuti.

- a) Administratori emërohet Z.Erion Nexha, i lindur më 14.04.1983 në Lushnje banues në Durrës me numër identifikimi I30414025J, cili do të ushtrojë këtë funksion deri në 20.05.2026 ose revokim nga shumica e ortakëve.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "Vision Consulting" sh.p.k do të jetë 123.000 (njëqindnjëzetetremije) Lekë. I cili është i pranuar, miratuar dhe nënshkruar nga ortakët.


Kapitali ndahet ne 3 (tre) kuota.

- a) Giancarlo Renzullo, shtetas italian, lindur më 28.06.1971, në Bolzano, banues në Bolzano me numër identifikimi C.F: RNZGCR71H28A952D.
Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetare në 62.730 (gjashtëdhjetëedymijëeshtatëqindetridhjetë mijë) Lekë.
- b) Erion Nexha, shtetas shqiptar, lindur më 14.04.1983 në Lushnje, banues në Durrës me numër identifikimi I30414025J.
Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 44% (dyzetë e katër përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetare në 54.120 (pesëdhjetëekatërmijënjëqindnjëzetë) Lekë.
- c) Lediana Shabani, shtetase shqiptare, lindur më 18.04.1986 në Durres, banuese në Durrës, më numër identifikimi I65418098A.
Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 5% (pesë përlind) të kuotës së kapitalit themeltare shprehur ne vlerë monetarë në 6.150 (gjashtëmijënjëqindepesëdhjetë) Lekë.

Kapitali nuk është derdhur ende në një llogari bankare

Ortakët

Z. Giancarlo Renzullo

Përfytyesuar me prokur.
Erion Nexha 

Z. Erion Nexha

Erion Nexha



Znj. Lediane Shabani

Lediane Shabani

A stylized handwritten signature in black ink, appearing to be 'Lediane Shabani'.

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

I. Selia, objekti dhe kohëzgjatja

Neni 1

Data e themelimit, emërtimi dhe ortakët .

1.Sot,më 21.06.2021 në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “Vision Consulting” sh.p.k

2-Themeluesit e shoqërisë janë:

- a) Giancarlo Renzullo;
- b) Erion Nexha;
- c) Lediana Shabani.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë tregtare private “Vision Consulting” sh.p.k ndodhet në adresën: Rruga “Jordan Misja”, Hyrja 1, Apartamenti 5, Zona kadastrale Nr.8330, Nr. i Pasurisë 8/176+1-5, Tiranë.

Transferimi i shoqërisë brënda të njëjtit qytet nuk duhet të konsiderohet si ndryshim i statutit apo marveshjeve të palëve të përfshira duke qënë se selia ndodhet në të njëjtin qytet.

Shoqëria mund te hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj vetëm me vendim te asamblesë dhe ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

- a) Konsulencës fiskale dhe tregtare;
- b) Përpunim të dhënash kontabël për llogari të palëve të treta;
- c) Shërbime outsourcing për shoqëri të huaja;
- d) Konsulencë financiare për të gjitha llojet e bizneseve;
- e) Studimi i tregut për investitorë vendas dhe të huaj;

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

- f) Hartim dhe projektim i planeve të biznesit, buxhetit dhe analizës financiare të shoqërive tregtare;
- g) Aktivitete të tjera të lejuara nga ligji tregtarë i Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria ka një kohëzgjatje pa afat, ajo mund ta përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- d) me vendim gjykate;
- e) për arsye të tjera të parashikuara në statut.

II.KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "Vision Consulting" sh.p.k do të jetë 123.000 (njëqindnjëzetetremijë) Lekë . Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 (tre) kuota, të cilat kanë vlerë të ndryshme por në asnjë rast vlera nuk mund të jetë më e vogël se një Lekë (1,00) secila. Kuotat do të zotërohen nga ortakë sipas ndarjes së mëposhtëm:

- a) Z. Giancarlo Renzullo është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kuotës së kapitalit themeltar shprehur në vlerë monetare në 62.730 (gjashtëdhjetëedymijëeshtatëqindetridhjetë mijë) Lekë.
- b) Z. Erion Nexha është Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 44% (dyzet e katër përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur në vlerë monetare në 54.120 (pesëdhjetëekatërmijënjëqindnjëzetë) Lekë.

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

- c) Znj. Lediana Shabani është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 5% (pesë përqind) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetrare në 6.150 (gjashtëmijënjëqindpesëdhjetë) Lekë.

Neni 6

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet kundrejt pagesës (përmes kontributeve të reja në para ose të kontributeve në natyrë) ose falas (nëpërmjet transferimit të rezervave në dispozicion të kapitalit), në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës në bazë të vendimeve të ortakëve vendimi për ndryshimin e kapitalit do të miratohet me shumicën e parashikuar për ndryshimet në statut. Kapitali mund të zvogëlohet në rastet dhe në përputhje me ligjin me anë te rezolutave të asamblesë së ortakëve që do të miratohen me shumicat e kërkuara për ndryshimin e statutit të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kuotave të kapitalit

1. Kuotat i garantojnë zotëruesëve të tyre të drejta të barabarta, ato janë të ndashme dhe të transferueshme me vepër midis personave të gjallë me miratimin e shprehur nga ortakët e tjerë me një votë të favorshme prej të paktën dy të tretave të kapitalit themeltar ose me trashëgimi për shkak të vdekjes. Ortaku i cili synon të shesë kuotat e tij duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë dhe të tregojë çmimin e ofruar nga blerësi. Në të njëjtat kushte ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave që janë vendosur në shitje, në proporcion me ato që aktualisht kanë në pronësi, kjo e drejtë duhet të ushtrohet brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e komunikimit, për këtë qëllim, propozimi për transferimin e kuotave, që përmban informacionin e përgjithshëm të blerësit dhe përshkrimin e kuotave që do te transferohen duhet t'u komunikohet ortakëve të tjerë nëpërmjet, letër rekomande, postë elektronike ose me anë të postës së certifikuar të propozimit të shitjes.
2. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:(Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 , Neni 73)

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

- a) Shitblerjes;
- b) Trashëgimia;
- c) Dhurimi;
- d) Në çdo llojë forme tjetër të parashikuar nga ligji ne fuqi.

Për të gjitha rastet e përshkruara më sipër, ortakët duhet të vendosin nëpërmjet thirrjes së asamblesë dhe pranimit me një vote të favorshme prej dy të tretave të kapitalit themeltar. Vendimi i ortakëve duhet ti komunikohet ortakut që do të transferoj kuotat nëpërmjet letrës rekomande, postës elektronike brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i propozimit, nëse ky afat përfundon dhe ortakët nuk kanë kthyer përgjigje, do të nënkuptohet që ortakët kanë refuzuar ofertën.

Në rast mos aprovimi të transferimit të kuotave, ortaku ka të drejtën e tërheqjes nga funksionet e tij sipas te drejtës që i jep ligji.

Transferimi i cili kryhet në kundërshtim me rregullat e mësipërme është i pavlefshëm dhe nuk ka ndikim në shoqërinë.

Në rastin e mortis causa, kuotat do ti kalojnë automatikisht trashëgimtareve të të ndjerit, te cilët duhet të emërojnë përfaqësuesin e tyre të përbashkët brënda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e vdekjes.

Trashëgimtare të njëjtin afat kanë të drejtë të refuzojnë të marin përsipër kuotat e ortaku të ndjerë dhe të kërkojnë likuidimin e tyre, i cili do te bëhet brënda fatit 6 (gjashtë) mujor nga data e vdekjes me vlerën e përcaktuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 8 të këtij statuti për përcaktimin e rimbursimit të ortakut që tërhiqet nga shoqëria dhe për këtë arsye, për këtë qëllim duhet të merën parasysh kapitali neto që rezulton nga regjistrat kontabël të shoqërisë duke përjashtuar nga vlerësimi çdo aktiv jo material që nuk është i kontabilizuar.

Neni 8

Tërheqja e antarëve themelues.

Ortakët themelues të shoqërisë nuk do të jenë në gjëndje të tërhiqen nga shoqëria ose të shesin kuota e tyre për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga themelimi, përveçse nëse autorizohet nga

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

asambleja e përgjithshme për rastet e konsideruara si të jashtëzakonshme me votë unanime të të gjithë ortakëve.

Kanë të drejtë të tërhiqen ortakët të cilët nuk kanë kontribuar në miratimin e vendimeve në lidhje me;

- e) Ndryshimi i objektivit të veprimtarisë së shoqërisë;
- f) Transformimin e i shoqërisë;
- g) Bashkimin e shoqërisë;
- h) Revokimin e statusit të likuidimit;
- i) Transferimit të shoqërisë jashtë;
- j) Përbushjes së veprimeve që sjellin ndryshime thelbësore në objektivin e veprimtarisë së shoqërisë;

E drejta e tërheqjes parashikohet në të gjitha rastet e tjera të parashikuara në ligj.

Ortaku i cili dëshiron të tërhiqet duhet t'ia komunikoj vendimin asamblesë së ortakëve me anën e letrës rekomande, postës elektronike ose asaj të zakonshme.

Ortakët të cilët tërhiqen nga shoqëria kanë të drejtë të rimbursohen për kuotën e kontribuar në proporcion me kuotën që kanë në kapitalin e shoqërisë. Për këtë qëllim ajo përcaktohet nga administratori duke marrë parasysh pasurinë neto që dalin nga pasqyrat e fundit financiarë të depozituara duke përjashtuar nga vlerësimi të gjitha elementët jo material të cilët nuk kontabilizohen.

Rimbursimi i kuotave të përfituar nga tërheqja duhet të kryhet brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve nga data e dhënies së vendimit.

Rimbursimi mund të vijë dhe si rezultat i blerjes së kuotave të kapitalit nga ortakët e tjerë në mënyre proporcionale me kuotat aktuale ose nga një palë e tretë e pranuar nga vetë ortakët. Në rastet kur kjo nuk ndodh do të bëhet rimbursimi duke përdorur rezervat e disponueshme të shoqërisë.

Në mungesë të rezervave në dispozicion, do të reduktohet kapitali themeltar i shoqërisë në përputhje me rrethanat; nëse nuk është e mundur të rimbursohet ortaku i tërhequr atëherë kompania është e detyruar të hapë procedurat e likuidimit në përputhje me Ligjin në fuqi.

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

III. ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9

Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organi vendimarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme;
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët dhe likuiduesit;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - j) shpërndarjen e dividendeve;
 - k) mbulimin e humbjeve;

çështje të tjera të parashikuara nga Ligji në fuqi dhe statuti.

Neni 10

Thirrja e asamblesë

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara me ligj ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Thirrja zakonshme e asamblesë ose thirrja në rastet urgjente duhet të bëhet sipas parashikimit të ligjit në fuqi, në rastet urgjente asambleja mund të mbledhet dhe jashtë selisë së shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Në njoftimin për mbledhjen e asamblesë mund të parashtrohet një datë e mëtejshme për një thirrje të dytë të asamblesë në rastet kur thirrja e parë nuk është realizuar sipas parashikimeve të ligjit, edhe në thirrjen e dytë janë të vlefshme rregullat e njoftimit si në thirrjen e parë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët dhe administratori janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret për diskutim sipas kompetencave të saj sa herë që organi administrativ e gjykon të përshtatshëm.

Thirrja e asamblesë duhet të bëhet nga organi administrativ në rastin kur e parashikon Ligji në fuqi.

Neni 11

Pjesëmarrja në asamble dhe e drejta e votës

Kanë të drejtë të marrin pjesë në asamble vetëm ortakët që janë të regjistruar në librin e ortakëve të paktë 5 (pesë) ditë përpara caktimit të asamblesë.

Çdo ortak mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë , administratorët e shoqërisë dhe punonjësit nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

I takon kryetarit të asamblesë të konstatojë rregullsinë e përfaqësuesve dhe në përgjithësi të drejtën për të marrë pjesë në mbledhje.

Asambleja drejtohet nga administratori i saj i vetëm, në rastet kur ai nuk mundet ose nuk dëshiron të ta ushtrojë këtë funksion ortakët e pranishëm caktojnë me shumicë absolute votash sipas kapitalit themeltar kryetarin e ri ndërmjet ortakëve, i cili cakton një procesverbal mbajtës edhe nëse nuk është ortak.

I takon kryetarit të konstatojë rregullsinë e thirrjes së asamblesë, të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të drejtojë dhe rregulloj veprimtarinë e asamblesë dhe të

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

konstatoj rezultatin e votave. Rezultatet e këtyre kontrolleve duhet të regjistrohen në procesverbal.

Neni 12

Kuorumi

Shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë prezent ortakët, që zotërojnë të paktën 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.

Vendimet e mbledhjes së asamblesë së ortakëve duhet të paraqiten në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe proçverbal mbajtësi i asamblesë dhe noteri nëse kërkohet me ligj. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të ortakëve, që janë shprehur kundër. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Vendimet e mbledhjes së ortakëve të marra me shumicë votash në përputhje me ligjin dhe me këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët e tjerë të cilët nuk kanë marrë pjesë ose nuk janë dakord. Çdo apelim ndaj vendimeve të asamblesë duhet të paraqitet në përputhje dhe brënda afateve të përcaktuara nga ligji.

Vendimet miratohen me ngritjen e dorës përveçëm në rastet kur shumica pjesëmarrëse kërkon të miratimin e vendimeve nëpërmjet thirrjes një nga një të emrave të pjesëmarrësve. Në çdo rast teknika e marrjes së vendimit duhet të jetë e qartë ose duhet të shprehet në mënyrë të tillë që të lejojë identifikimin e pjesëmarrësve që votojnë kundra.

Në rastet kur ortakët e asamblesë duhet të marrin vendime për çështje që kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas Nenit.87,Ligji Nr 9901 datë 14.04.2008, asambleja e përgjithshme vendos me 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

IV . ADMINISTRIMI

Neni 13

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

Emërimi, kohëzgjatja, shkarkimi, dhe mbyllja e organit administrativ .

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative sipas vendimit të asamblesë së ortakëve nga;

- a) Nga një administrator i vetëm;
- b) Nga një bord drejtues i përbër të paktën nga dy antarë;
- c) Nga një ose më shumë administratorë, të cilët e administrojnë veçmas ose bashkërisht shoqërinë, sipas kompetencave të përcaktuara në aktin e emërimit.

Administratorët mund të jenë edhe persona fizikë jo ortakë të shoqërisë, të cilët e ushtrojnë funksionin e tyre deri në shkarkimin ose dorëheqjen nga detyra, përveçse në rastet kur në statut është paracaktuar një afat për ushtrimin e funksionit nga ana e administratorit, në të tilla kushte ata kanë të drejtën të mund të rizgjidhen sërisht mbas mbarimit të afatit.

Përfundimi i ushtrimit të funksionit të administratorit për shkak të mbarimit të afatit të paracaktuar hyn në fuqi nga momenti i krijimit të organit të ri administrativ.

Ne rastet kur emërohen dy ose më shumë administratorë dhe kompetencat e tyre nuk janë të ndara ose të përcaktuara, nënkuptohet që është ndërtuar një bord administrativ.

Neni 14

Kompetencat e organit administrativ.

Nëse shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm atij i jepen kompetencat e administrimit të veprimtarisë së përditshme të shoqërisë duke përfshirë këtu hapjen e llogarive rrjedhëse dhe negocimin e kushteve, për rastet e veçanta administratorit i duhet miratim nga asambleja.

Në aktin e emërimit mund të përcaktohen kufizime të kompetencave të administratorit, në këtë rast, kompetencat të cilat nuk janë deleguar do të jenë ekskluzivisht kompetenca të asamblesë së ortakëve të cilat do të zgjidhet me kuoromet e parashikuara në Nenin 13 .

Neni 15

Përfaqësimi

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i shoqëris në mardhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj të parashikuara nga ligji dhe statuti.

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

Në rastin e emërimit të këshillit të administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë i përket kryetarit të këshillit të administratorëve dhe delegatëve nëse janë të autorizuar.

Në rastin e emërimit të më shumë administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë i takon bashkarisht ose veçmas, në të njëjtën mënyrë siç i janë atribuar kompetencat gjatë emërimit të tyre.

Neni 16

Përgjegjësit e administratorit

Administratori është individualisht përgjegjës, kundrejt shoqërisë dhe palëve të treta, për shkeljet e ligjit, për shkelje të statutit ose për papërgjegjshmëritë e kryera gjatë ushtrimit të funksionit.

Pasojat që shkaktohen nga marrveshjet e nënshkuara pa miratimin e këshillit të asamblesë të cilat e dëmtojnë shoqërinë, dëmshpërblehen nga administratori.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

V. Të drejtat e ortakëve që nuk janë administrator .

Neni 17

Të drejtat e ortakëve .

Ortakët që nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë të informohen nga administratori për mbarvajtjen e shoqërisë dhe të shqyrtojnë edhe nëpërmjet profesionistëve të tyre të besuar, procesverbalet dhe dokumentacionin e shoqërisë të lidhur me administrimin.

VI.Pasqyrat financiare dhe fitimi .

Neni 18

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti .Viti i parë ushtrimor mbyllet më 31 Dhjetor 2021

Në fund të çdo viti ushtrimor organi administrativ do të hartojë bilancin dhe do të llogarisë fitim-humbjen në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 19

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

VISION CONSULTING SH.P.K

Fitimet.

Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 (pesë) përqind të kësaj vlere, dhe vlera e mbetur do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat në pronësi të tyre përjashtuar rastet kur asambleja ka vendosur ndryshe.

Shoqëria llogarit dhe ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura më sipër.

VII.PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI .

Neni 20

Shpërndarja e shoqërisë dhe likuidimi

Shpërndarja e më hershme e shoqërisë miratohet nga asambleja e përgjithshme me shumicën e votave të parashikuara për ndryshimin e statutit.

Në rastet kur verifikohet një nga arsyet e të cilat çojnë në shpërbërjen e shoqërisë të parashikuara nga Kodi Civil dhe ligjet në fuqi ose nga dispozita të tjera të përcaktuara në Statut.

Me miratimin e shpërbërjes dhe likuidimit të shoqërisë, këshilli i asamblesë do të emërojë konform ligjit një ose më shumë likuidues, duke i përcaktuar atyre kompetencat dhe tarifat.

VIII.DISPOZITA PERFUNDIMTARE.

Neni 21

Huamarrje nga ortakët

Për çdo hua të marrë nga ortakët në favor të interesave të shoqërisë do të konsiderohet pa interes sepse hua të tilla do të kryhen nga vetë ortakët në përpjestim me kuotat e mbajtura përkatësisht.

Neni 22

Për çdo rast që nuk parashikohet shprehimisht në këtë statut do të referohemi dispozitave të Kodit Civil dhe dispozitave për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar parashikuar nga Ligji. Nr.9901, datë 14.4.2008.


STATUI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR


VISION CONSULTING SH.P.K

Ortakët:

Z. Giancarlo Renzullo

perfaqësues me prokur
Erion Nexha 

Z. Erion Nexha

Erion Nexha


Znj. Lediana Shabani

Lediana Shabani


Rep.n. 118.056

----- PROCURA SPECIALE -----

----- REPUBBLICA ITALIANA -----

Il quattro giugno duemilaventuno.
In Bolzano, nel mio studio in Corso della Libertà, n. 15.
Innanzi a me dott. Angelo Finelli, Notaio in Bolzano,
iscritto nel Ruolo del Distretto Notarile di Bolzano.

----- SI E' COSTITUITO: -----

RENZULLO Giancarlo, nato a Bolzano il 28 giugno 1971 e
residente a Bolzano, Via della Torre n. 12, dottore
commercialista, cittadino italiano,
Codice Fiscale: RNZ GCR 71H28 A952D e documento d'identità
n. 1649-I-A.

Detto Comparsente, della cui identità personale io Notaio
sono certo, col presente atto dichiara di nominare, come
nomina e costituisce suo procuratore speciale e per quanto
infra generale il Sig.

NEXHA Erion, nato a Shqiptare (ALBANIA) il 14 aprile 1983 e
residente a Durazzo (ALBANIA), Rruga "Taulantia" n. 1,
cittadino albanese, Codice Identificativo I30414025J e
documento d'identità n. 036344897,

----- p e r c h é -----

in nome, vece e conto di esso mandante, oltre che in
proprio, intervenga nell'atto col quale sarà costituita una
società di diritto Albanese, con denominazione "**VISION
CONSULTING SH.P.K.**" e sede a Tirana (ALBANIA) Rruga "Jordan
Misja", Hyrja n. 1, Apartamenti 5, Zona kadastrale n. 8330,
Nr.i Pasurisë 8/176+1-5, con **durata** illimitata ed **oggetto
sociale** avente le seguenti attività: gestione aziendale,
consulenza aziendale e consulenza gestionale in genere,
attività in campo amministrativo, attività combinate di
servizi di amministrazione dell'ufficio, elaborazione dei
dati, hosting delle informazioni e attività connesse,
consulenza fiscale, ricerche di mercato e sondaggi,
preparazione di documenti e altre attività specializzate di
supporto agli uffici, il tutto nel rispetto delle norme di
legge applicabili in Albania; il capitale sociale ammonta ad
Lekë 123.000 (centoventitremila) che sarà sottoscritto dai
soci in denaro.

Il nominato procuratore è pertanto autorizzato a
sottoscrivere l'atto costitutivo, meglio definire la sede,
l'oggetto, la quota di capitale sottoscritta da ciascun
socio ed in particolare quella sottoscritta da esso mandante
che dovrà essere corrispondente al **51%** (cinquantuno per
cento) del capitale sociale ovvero per complessivi Lekë
62.730 (sessantaduemilasettecentotrenta), definire tutti gli
elementi previsti dalla legge e ogni e qualunque patto
sociale che ritenga opportuno, nominare l'organo
amministrativo, nella persona della parte mandataria,
compiere quant'altro utile e necessario senza che al



nominato procuratore possa mai essere opposta mancanza o
insufficienza di poteri che tutti qui si intendono conferiti.
Il tutto con promessa fin d'ora di rato e valido sotto gli
obblighi di legge, e senza bisogno di ulteriore ratifica o
conferma e da esaurirsi in un unico contesto. -----

Richiesto del presente atto, scritto a macchina da persona
di mia fiducia su un foglio per una facciata intera e quanto
sin qui della presente, ne ho dato lettura al Costituito,
che, da me Notaio interpellato, lo approva e lo sottoscrive,
con me Notaio. -----

Giuseppe Sestini

Carlo Sestini





PROCURA DELLA REPUBBLICA PRESSO IL TRIBUNALE DI BOLZANO

Ufficio locale del casellario
Piazza del Tribunale 1 - 39100 BOLZANO
☎ +39 0471-226297
e-mail: casellario.procura.bolzano@giustizia.it

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Stato: Italia
il presente atto pubblico
2. è stato firmato da: Angelo Finelli
3. operante in qualità di: notaio
4. è munito del sigillo: Finelli Angelo fu Gabriele notaio in Bolzano

Attestato

5. in Bolzano
6. il 09/06/21
7. dal Procuratore della Repubblica
8. col numero 498/2021 registro apostilles
9. Sigillo
10. Il Procuratore della Repubblica




IL PROCURATORE DELLA REPUBBLICA
DER STAATSANWALT
Sost. - Dr. Günter Morandell - Stellv.

Nr. 118.056 Repertori

**PROKURË E POSAÇME
REPUBLIKA E ITALISË**

Data katër qershor dymijë e njëzet e një.-----

Në Bolzano, në studion time në adresën Corso della Libertà, nr.15.-----

Para meje Dr. Angelo Finelli, Noter në Bolzano, i regjistruar në Kolegjin e Rrethit të Noterëve të Bolzano, -----

-----U PARAQIT PERSONALISHT:-----

Giancarlo RENZULLO, i datëlindjes 28 qershor 1971, lindur dhe banues në Bolzano, në adresën Via della Torre nr.12, kontabilist privat, shtetas italian,-----

me Kod Fiskal RNZ GCR 71H28 A952D dhe dokument identifikimi nr. 1649-I-A.

I përfaqësuari, për identitetin personal të të cilit unë Noteri jam i sigurt, me anë të këtij akti deklaroi se emëron dhe cakton si përfaqësues të vetin të posaçëm, në terma më të përgjithshëm:

Z.Erion NEXHA, i datëlindjes 14 prill 1983, lindur në Shqipëri dhe banues në Durrës, Shqipëri, në adresën Rruga "Taulantia" nr.1, shtetas shqiptar, me dokument identifikimi nr.036344897 me numër personal identifikimi I30414025J , -----

----- **me qëllim që**-----

në emër, për llogari dhe në interesin e të përfaqësuarit, dhe të tij, të marrë pjesë në aktin e themelimit të një shoqërie me të drejta të kufizuara në Shqipëri, me emrin "**VISION CONSULTING SH.P.K**" dhe seli në Tiranë (Shqipëri), Rruga "Jordan Misja", Hyrja nr.1, Apartamenti 5, Zona Kadastrale nr.8330, Numri i pasurisë 8/176+1-5, me **kohëzgjatje** të pakufizuar të veprimtarisë dhe **objekt të shoqërisë** aktivitetet e mëposhtme: menaxhim biznesi, konsulencë biznesi dhe konsulencë për menaxhim në përgjithësi, aktivitete në fushën administrative, aktivitete të kombinuara të shërbimeve administrative të zyrës, përpunimin e të dhënave, ruajtjen e informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to, konsulencë tatimore, studim tregu dhe sondazhe, përgatitja e dokumenteve dhe aktivitetet e tjera të specializuara në ndihmë të zyrave, të gjitha në përputhje me rregulloret dhe ligjet e zbatueshme në Shqipëri; kapitali aksionar arrin në **123.000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë** dhe do të nënshkruhet nga aksionarët me para në dorë.-----

Përfaqësuesi i posaçëm është gjithashtu i autorizuar të nënshkruajë aktin e themelimit, të përcaktojë më mire selinë, objektin, kuotën e kapitalit të nënshkruar nga secili aksioner dhe në veçanti kuotën e nënshkruar nga i përfaqësuari që duhet të jetë korresponduese me **51 %** (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë ose për një total prej 62.730 (gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë) Lekë, të përcaktojë të gjitha elementet e parashikuara nga ligji dhe çdo pakt shoqëror që e konsideron të përshtatshëm, të emërojë organin administrativ, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit kryesor, të bëjë çfarëdo tjetër që është e dobishme dhe e nevojshme në mënyrë që Përfaqësuesi të mos kundërshtohet asnjëherë për pasaktësi apo për mungesë të të drejtave, të cilat do të konsiderohen të konfirmuara.

Të gjitha veprimet e kryera cilësohen të drejta dhe të vlefshme, në përmbushje të detyrimeve ligjore, pa detyrimin e dhënies llogari dhe të kryera në një kontekst të vetëm.

Akti i mësipërm, hartuar me kërkesë të të përfaqësuarit, shkruar me sistem elektronik nga personi im i besuar në një fletë me një faqe të plotë e deri këtu në këtë akt, të cilin unë Noteri ia kam lexuar dhe ia shpjeguar, dhe i përfaqësuari e aprovon dhe e nënshkruan në prezencën time Noterit.

/firma, vula e noterit/

**Prokuroria e Republikës
Pranë Gjykatës së Bolzano**

Zyra Vendore e Policise Gjyqësore
Piazza del Tribunale 1 – 39100 Bolzano
+390471226297
e-mail: casellario.procura.bolzano@giustizia.it

Apostile

(Konventa e Hagës, datë 5 Tetor 1961)

1. Shteti : Itali

Ky akt publik është nënshkruar nga Angelo Finelli

3. në cilësinë e Noterit

4. mban vulën e Angelo Finelli fu Gabriele Noter në Bolzano

Vërtetuar

5. Në Reggio Bolzano me datë 09/06/2021

7. Nga Prokurori i Republikës

8. Me numrin 498/2021 të Regjistrimit të Apostileve

9. Vulë : Prokuroria e Republikës

- Bolzano

10. Firma: Prokurori i Republikës
Dr. Gunter Morandeli /firma, vula/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER ALBA F. ÇELA



V2021010920105078192

DATE 21/06/2021
NR REP 1140

VËRTETIM PËRKTHIMI

Unë notere ALBA F. ÇELA, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë noteriale në adresën “Lagja NR.11, Rruga ALEKSANDER GOGA, KATI I PARE, Durrës”, deklaroj se kam përkthyer me saktësi dokumentin bashkëngjitur “Procura Speciale (Prokurë e Posaçme)”, nga gjuha Italiane në gjuhën Shqipe.

Përkthimi është bërë nga unë Noteri në bazë të nenit 135 të Ligjit nr.110/2018 datë 20.12.2018 “Për Noterinë” në Republikën e Shqipërisë.



NOTERE
ALBA F. ÇELA

Alba Çela.
Alba